

KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot më Datë 25/08 2023, lidhet kjo Kontratë Shit-Blerje Kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

Shitësit: Z. Nelsi GEGA atësia Kadri, amësia Vasilika, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje më 16.01.1987 dhe banues në TIRANË, me adresë rruga Pjeter Bogdani, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim nr. personal I70116059V

Blerësit: Z. Bujar BENDO, atësia Pelivan, shtetas Shqipëtar, lindur në Lushnje më 02/07/1966 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. Personal G60702148I.

(I cili në vijim të kësaj Kontrate do të referohen si "Blerësi")

Këtej e tutje "Shitësi dhe "Blerësi", bashkërisht do të quhen "Palët" dhe individualisht secili prej tyre mund të quhet edhe "Pala".

Meqënëse:

1. Shitësi Z. Nelsi Gega, është zotërues i një kuote të vetme të shoqërisë me vlerën 2,000.000 (dy milion) lekë ose për 20% të kapitalit në shoqërinë "Interinvest Albanian Group" sh.p.k, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NIPT M22414027J, Investitor dhe investime në fushën e ndërtimit. Të tregtojë, ndërmjetësojnë rolin e agjentit real estate për transaksione të pasurive të patundshme të gjitha llojeve brenda dhe jashtë kufijve shtetëror shqiptar. Te jap me qera, ndërmjetësoj për dhënie me qira, në huapërdorje dhe çdo lloj forme tjetër administrimi të pasurive të paluajtshme. Konsulenca të përgjithshme dhe çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme
 - Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, me një vlerë prej 10.000.000 (dhjetë milion) lekë.
 - Përmes kësaj kontrate, Shitësi shpreh vullnetin në formën e parashikuar nga ligji, për të transferuar nëpërmjet shitjes 1(nje) kuotë në vlerën vlerën 2,000.000 (dy milion) lekë në favor të Z.Bujar Bendo
 - Të sipërpërmendurit, bazuar në Nenin 73/1 b të Ligjit Nr.9901 Dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe Nenin 705 dhe vijues të Kodi Civil, ranë dakort për kushtet e kësaj Kontrate Shitje Kuotash, si vijon:



Neni 1

Objekti i kontratës dhe vlera

- 1.1 Shitësi Z. Nelsi Gega është zotërues i një 1(një) kuote e cila përfaqëson 20% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Interinvest Albanian Group” sh.p.k, dhe pranon të transferojë kuotën e tij prej 20 % (njëzet përqind) nëpërmjet shitjes, Z Bujar Bendo kundrejt vlerës nominale 2.000.000 (dy milionë) lek.
- 1.2 Si pasojë e shitjes së mësipërme, Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë “Interinvest Albanian Group” sh.p.k do të përbëhet nga 1 (një) kuotë e vetme, përkatësisht:
- **Z. Bujar Bendo, Ortak i vetëm i shoqërisë, me 1 (një) kuotë, ose 100 % të kapitalit të shoqërisë me vlerën 10.000.000 (dhjetë milion) lekë.**

Neni 2

Mënyra e pagesës

Pala blerëse do të kalojë vlerën përkatëse në numrin e llogaritur të palës shitëse në kontratë. Pavarësisht mënyrës së pagesës blerësi bëhet zotërues i kuotës menjëherë me nënshkrimin e saj.

Neni 3

Detyrimet e Shitësit

1. Pala Shitëse nëpërmjet kësaj kontrate deklaron dhe garanton Blerësit:
- a. Shoqëria është person juridik i regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe ushtron aktivitet tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe dispozitave të statuti;
 - b. Pala Shitëse garanton se kuota objekt i kësaj Kontrate është e lirë nga çdo peng, barrë sigurorese, hipotekë, apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre;
 - c. Shoqëria nuk është në proces falimentimi ose likuidimi.

Neni 4

Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka detyrimin të depozitojë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me qëllim për t'u reflektuar në ekstraktin e Shoqërisë, ndryshimet në rrethin e ortakëve.

Neni 5

Pasojat e Kontratës së Shitblerjes

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë "Interinvest Albanian Group" Sh.p.k përbëhet nga 1 (një) kuotë e vetme, sipas përcaktimeve të nenit 1 pika 2.

Neni 6


Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

SHITËSITI

Z. Nelsi Gega



BLERËSI

Z. Bujar Bendo

